



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1768 Prot.

Tiranë, më 28.12.2021

V E N D I M

Nr. 253, Datë 28.12.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 232 Regj., datë 10.12.2021¹, të A. Gj, kundër Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, (DV ASHK) Sarandë dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) , me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjendjes ekonomike” dhe “gjendjes shoqërore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në dokumentacionin dhe parashtrimet e sjella nga subjekti ankues, A. Gj, rezulton se ai pas vitit 1995 ka ndërtuar një shtëpi banimi në truallin e disa zyrave të ish-Ndërmarrjes së Ujrave, Fshati Vrion, Bashkia Finiq, truall të cilin ankuesi ia ka blerë shtetasit A. M.

Referuar Vertetimit datë 28.10.2021, të Kryetarit të Fshatit Vrion, rezulton se A. Gj banon në zyrat e ish-Ndërmarrjes së Ujrave Vrion, që prej muajit prill 1998 e në vazhdim.

Nëpërmjet Formularit të Vetëdeklarimit me nr. 118 prot., datë 04.10.2006, ankuesi ka aplikuar pranë DV ASHK Sarandë për legalizimin e ndërtimit, banesës së tij mbi këtë truall.

Ankuesi ka pretenduar se, Drejtora Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Vrion-Sarandë është vendosur me disa zyra pranë banesës së tij, në vitin 2005, shumë vite pasi ai e kishte ndërtuar banesën dhe jetonte në të.

Ankuesi ndër të tjera, është shprehur se: *“Kam ndërtuar një shtëpi banimi para rreth 25-27 viteve në një truall shtetëror në një zonë industriale të Fshatit Vrion, Bashkia Sarandë dhe aty nuk kishte asnjë ent shtetëror asokohe. Në vitin 2006 kam depozituar vetëdeklarimin për*

¹ Plotësuar me e-mailin e sjellë me datë 17.12.2021.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

legalizimin e objektit informal, banesës sime. Por, edhe pse ka kaluar një kohë shumë e gjatë ne jo vetëm nuk na u legalizua shtëpia, por me datë 02.11.2021 jam vënë në dijeni të shkresës me nr. 112271/3 prot., datë 01.11.2021 të DV ASHK Sarandë, ku bashkëlidhur më ka përcjellë shkresën “Vendim për moslegalizim të ndërtimit pa leje me nr. 844, datë 01.11.2021, që i përket vetëdeklarimit me nr. 118 prot., datë 01.11.2006, me vendndodhje në Fshatin Vrion, Bashkia Finiq. Ky vendim është i kundraligjshëm pasi dosja e administruar nga DV ASHK Sarandë i përmbush të gjitha kriteret kualifikuese të parashikuara në Udhëzimin nr. 1451 prot., datë 07.10.2015 “Për përcaktimin e modelit dhe mënyrën e plotësimit të vendimit të kualifikimit, si dhe çdo pikë të VKM nr. 756, datë 26.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje ”.

Me Vendimin nr. 244, datë 02.11.2021 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, IKMT ka vendosur: *“Dënimin e kundërvajtësit A. Gj me prishjen e objektit të kundërligjshëm, objekt 1 kat+mur rrethues me blloqe, ndodhur në adresën truall në pronësi shtet, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor Sarandë, Bashkia Finiq”.*

Me Vendimin nr. 245, datë 02.11.2021 “Për dënimin me gjobë”, IKMT ka vendosur: *“Dënimin e kundërvajtësit A. Gj me gjobë...”.*

Ankuesi në parashtrimet e veta ka pretenduar se, brenda 24 orëve nga dalja e vendimit për prishjen e objektit/banesës së tij, punonjësit e IKMT në mënyrë barbare prishën banesën e tij, pa asnjë njoftim paraprak për ta liruar atë dhe për të nxjerrë jashtë objektet e saj.

Ankuesi ka pretenduar se, moslënia e afatit 10 ditor, të përcaktuar në ligj, për ankimimin e vendimit të moslegalizimit apo prishjes së objektit para një organi më të lartë apo gjykatës kompetente, ka shkelur të drejtën e tij themelore për ankimim dhe ka mohuar mbrojtjen e tij nga veprimet arbitrare të organeve administrative.

Subjekti ankues ka pretenduar se shkak për diskriminim e shkaktuar nga DV ASHK Sarandë dhe IKMT është bërë gjendja ekonomike, si njerëz që nuk kanë miq dhe të njohur në hierarkinë politike të vendit. Ai ka cituar ndër të tjera se: *“Shtëpia e jonë në rreth 500 000 banesa në të gjithë vendin ishte bërë në tokën e shtetit që tek e fundit është shteti jonë dhe i të gjithëve dhe ka ligje se si duhet trajtuar një rast si i yni (banesa jonë është mbi 25 vjeçare). Dëmi që na ka ndodhur është nga papërgjegjshmëria e institucioneve shtetërore vetëm për të përfutur ndonjë palë e tretë nga ndonjë investim i panevojshëm duke u justifikuar se sheshi është brenda hartës së pronësisë së DSHTRR. Por kur është ndërtuar shtëpia jonë, aty nuk kishte Drejtori Transporti fare, por vetëm disa objekte të vjetra të prishura. Nuk e dimë si e kanë përfshirë edhe shtëpinë tonë brenda truallit të kësaj Drejtorie, gjë për të cilën nuk kishim ndonjë informacion apo njoftim, në mënyrë që ta zgjidhnim ligjërisht”.*

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të tij lidhur me mohimin e së drejtës së ankimimit dhe mbrojtjes ligjore brenda afateve të përcaktuara në ligj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet e-mailit datë 13.12.2021 Komisioneri ka njoftuar subjektin ankues³, se gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, ka konstatuar se ajo nuk plotëson kriteret formale dhe ka kërkuar nga ana e tij ta plotësojë atë, duke provuar e dokumentuar shkakun e pretenduar, si dhe të depozitojë dokumentacion provues lidhur me sa ka pretenduar.
2. Në informacionin e dërguar nëpërmjet e-mailit, me datë 17.12.2021, subjekti ankues ka bashkëlidhur e-mailit kopje të dokumentacionit poshtëcituar⁴:

³ Në adresën personale të e-mailit të ankuesit: arjangjeci59@gmail.com

⁴ Nuk ka depozituar ndonjë provë apo fakt që të provonte se posedonte shkakun e pretenduar, atë të *“gjendjes ekonomike”* dhe *“gjendjes shoqërore”*.

- Ankimim kundër DV ASHK Sarandë, drejtuar ASHK, me objekt: *“Ankimim kundër aktit administrativ, Vendimit nr. 844, datë 01.11.2021 “Vendim për moslegalizimin e ndërtimit pa leje (shtëpia jonë e banimit) të DV ASHK Sarandë, si një vendim në shkelje të ligjit duke na diskriminuar për arsye të pamundësisë ekonomike dhe pozitës shoqërore”. Ankuesi ka kërkuar shfuqizimin e këtij akti administrativ, (duke cituar se: është një vendim në shkelje të ligjit duke na diskriminuar për arsye të pamundësisë ekonomike dhe pozitës shoqërore, pasi jemi njerëz të thjeshtë dhe të varfër ekonomikisht) dhe të urdhërohet DV ASHK Sarandë të përfundojë procedurat e legalizimit.*
- Kallëzim penal kundër Kryeinspektorit të IKMT-së, drejtuar Prokurorisë së Posaçme (SPAK), me objekt: *“- Kërkojmë ndjekjen penale për Kryeinspektorin e IKMT A. Z, për shpërdorim të detyrës, të kryerjes së veprimeve arbitrare, të mosmarrjes së masave për të rivendosur ligjshmërinë dhe vepra të tjera penale që do të dalin gjatë hetimit të këtij kallzimi. - Ndjekjen penale për Kryeinspektorin dhe punonjësit e IKMT-së që kanë ekzekutuar vendimin për prishjen e shtëpisë sonë, për sjellje arrogante duke përdorur forcën në disproporcion me familjen tonë me katër anëtarë, pasi nuk na lanë kohën prej 10 ditësh që është parashikuar në ligj për ekzekutimin e një vendimi për prishje objekti dhe si pasojë u shkatërruan sendet që ishin brenda në shtëpi, si për përdorimin e dhunës dhe forcës së pajustificuar kundër nesh”.*

Në parashtrimet e tij para Prokurorisë, ankuesi ndër të tjera ka pretenduar diskriminim nga ana e punonjësve të IKMT-së, duke cituar shprehimisht se: *“...shkelja e këtyre të drejtave nga i kallëzuari (Drejtori i IKMT-së) dhe vartësit e tij kanë sjellë pasoja të rënda në familjen tonë jo vetëm se na kanë shkatërruar pasurinë, por na kanë diskriminuar duke u tallur, duke u kënaqur dhe kjo na krijoi idenë e një sjelljeje arrogante shtetërore të të fortit më të dobët, pra me familjen tonë të varfër. Mendojmë se nga hetimi do të vërtetohet shkelja e ligjit nga të kallëzuarit, duke na shkakuar jo vetëm dëm material, por edhe dëm jopasuror, psikologjik, pasi pamë të na shkatërrohej pasuria jonë familjare gjë që mund të evitohej...”*

- Kërkesë-padi kundër: DV ASHK Sarandë dhe IKMT, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me objekt:

“1. Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimit nr. 844, datë 01.11.2021, të DV ASHK Sarandë, për moslegalizimin e ndërtimit pa leje të vetëdeklaruar në procedurat e legalizimit me formularin e vetëdeklarimit nr. 118 prot., datë 04.10.2006.

2. Detyrimin e DV ASHK Sarandë të vazhdojë procedurat e legalizimit për objektin informal me nr. 118 prot., datë 04.10.2021 dhe të më pajisë me leje legalizimi për objektin dhe truallin.

3. Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimit nr. 244, datë 02.11.2021 “Për prishjen e objektit të kundraligjshëm” të IKMT.

4. Shfuqizimin e aktit administrativ, Vendimit nr. 245, datë 02.11.2021 “Për dënimin me gjobë” të IKMT.

5. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar nga prishja e objektit në mënyrë të paligjshme në masën që do të përcaktojnë ekspertët përkatës.

6. Shpenzimet gjyqësore për ekspert, avokat dhe çdo shpenzim tjetër t’i kalojnë palës së paditur.”

Neni 91/3 i Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, parashikon se: “Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, të sjellë si provë pranë Komisionerit, rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues, për diskriminim nga ana e DV ASHK Sarandë dhe IKMT, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se të njëjtat fakte, rrethana e shkaqe që janë paraqitur edhe përpara Komisionerit, janë bërë prezent në parashtrimet e paraqitura para Gjykatës, nga ana e ankuesit.

Në parashtrimet e kërkesë padisë së bërë nga ankuesi pranë kësaj Gjykate, ndër të tjera, citohet se: “...pala e paditur ka shkelur ligjin duke e diskriminuar paditësin dhe familjen e tij, pasi nuk i la afatin 10 ditor që paditësi të kishte të drejtën e ushtrimit të ankimit administrativ ose gjyqësor të këtyre dy vendimeve.

...veprimet e palës së paditur tregojnë qartazi arrogancën e organit administrativ mbi familjen e paditësit, një familje e thjeshtë dhe në pamundësi të përballonte këto veprime....”.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë dhe diskriminues nga ana e DV ASHK Sarandë dhe IKMT, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai

mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilitparashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se:

“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se:

“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për

pushimin e çështjes“, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 232 Regj., datë 10.12.2021, të A. Gj dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se:

“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁵, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 232 Regj., datë 10.12.2021, të paraqitur nga A. Gj, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Gjendja ekonomike, gjendja shoqërore

Lloji i vendimit: Pushim shqyrtimi

⁵ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.